



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJE	
<b>REKTORATI</b>			
Nr. / Br. / No. <u>368</u>		Nr. i faqj. Br. str / No. pg <u>6</u>	
Data / Datumi / Date: <u>18.02.2020</u>		Pejë / Poë	

SENATI

Ref.

Datë:

## RREGULLORE E PUNËS E KËSHILLIT TË ETIKËS TË UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA" NË PEJË

Pejë, Janar 2020

## **Neni 1**

### **Dispozitat e përgjithshme**

1. Kjo Rregullore përcakton kornizën procedurale për zbatimin efektiv të Kodit të Etikës nga Këshilli i Etikës të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë. Rregullorja përcakton rolin e Këshillit të Etikës si organ kompetent për mbikëqyrje etike dhe profesionale të personelit akademik dhe menaxherial në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë. Po ashtu kjo rregullore mbulon procedurat të cilat zhvillohen për shkeljet të Kodit të Etikës nga ana e studentëve.
2. Këshilli i Etikës pranë Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë shqyrton raste të cilat kanë të bëjnë me shkeljen e Kodit të Etikës të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë. Këshilli i Etikës pranon ankesa me shkrim për shkeljet e pretenduara të Kodit të Etikës nga palët brenda ose jashtë universitetit. Këshilli nuk inicion hetime ex-officio .
3. Gjatë punës se tij, Këshilli i Etikës bazohet në parimet e objektivitetit dhe trajtimit të plotë të çështjeve, p.sh., ashtu siç janë të parashtruara nga palët. Këshilli i Etikës e ka për obligim të zhvillojë procedurat që sigurojnë një trajtim të barabartë, të drejtë për secilin rast.
4. Për të mbrojtur interesat e palëve në një çështje, Këshilli i Etikës obligohet që dokumentet të cilat lidhen me rastet individuale të ruhen si konfidenciale. Në rrethana të veçanta, Këshilli i Etikës gjithashtu mund të vendosë që të shqyrtojë ankesa anonime, me kusht që të dëshmohet se hetimi dhe zgjidhja e ankesës do të shkaktonin dëme ankuesit.

## **Neni 2**

### **Emërimi i Këshillit të Etikës**

1. Këshilli i Etikës përbëhet nga nëntë anëtarë në këtë përbërje: Prorektorja për mësimdhënie, çështje studentore dhe kërkime shkencore, Prorektori përgjegjës për cilësi, Sekretari i Universitetit, një përfaqësues i Këshillit Drejtues nga stafi akademik, një anëtar i përbashkët nga Fakultete e Biznesit dhe MTHM, nga një anëtar nga Fakulteti Juridik, i Arteve dhe Agrobiznesit dhe një student.
2. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit të Etikës emërohen për një periudhë tre vjeçare.
3. Anëtarët e Këshillit të Etikës duhet të gëzojnë reputacion të lart akademik, të jenë të pavarur dhe të paanshëm. Përbërja e Këshillit të Etikës duhet të respektojë parimin e barazisë gjinore.
4. Në mungesë të një anëtari, apo në rastet kur një anëtar parandalohet nga shkaqet e ndryshme (konflikt interesi, sëmundja, dorëheqja) të marrë pjesë në punën e Këshillit të Etikës, atëherë përgjatë mungesës së anëtarit, Rektori emëron një anëtar tjetër.
5. Rektori emëron një sekretar në Këshillin e Etikës nga stafi administrative i universitetit.

### Neni 3

#### Kompetenca e anëtarëve të Këshillit të Etikës

Këshilli i Etikës ka këto kompetenca:

1. Të konceptojnë rregullat, qëllimin dhe përmbajtjen e parimeve etike që lidhen me punën e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë;
2. Shqyrton të gjitha çështjet etike që lidhen me kërkimin shkencor dhe punën akademike të mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve, personelit menaxherial dhe studentëve të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë;
3. Analizon etikën në punën praktike të mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve dhe studentëve të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë;
4. Këshilli i Etikës gjithashtu është i autorizuar të shqyrtojë gabimet dhe shkeljet e stafit menaxherial të Universitetit në lidhje me rregullat që zbatohen për Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.
5. Shqyrton rastet që kanë të bëjnë me kualifikimet dhe kompetencat hulumtuese dhe analizojnë rreziqet e mundshme që mund të shfaqen gjatë fazës së punës eksperimentale;
6. Siguron dhe mbron parimet e etikës për punën eksperimentale që prekin njerëzit, kafshët dhe ambientin;
7. Nëse lind një mosmarrëveshje për kompetencën e veçantë të një anëtari, Këshilli i Etikës duhet t'i drejtohet Këshillit Drejtues përmes Rektoratit.
8. Këshilli i Etikës është i obliguar të dorëzojë një raport vjetor Rektorit të Universitetit pas përfundimit të çdo viti akademik.
9. Të vëzhgojë zbatimin e dispozitave të këtij Kodi dhe të propozojë ndryshime, përmirësime apo masa të tjera detyruese që kanë të bëjnë me etikën në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.
10. Të shqiptojë masa disiplinore në lidhje me shkeljet të parashikuara në nenin 29.
11. Këshilli i Etikës shqyrton vetëm rastet kur denoncimi, ankesa apo raportimi kanë të përcaktuar individin që bën ankesën.

### Neni 4

#### Pavarësia dhe paanshmëria e Këshillit të Etikës

1. Këshilli i Etikës gëzon pavarësi institucionale.
2. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë garanton dhe mbron pavarësinë institucionale të Këshillit të Etikës.
3. Pavarësia dhe paanshmëria e anëtarëve të Këshillit të Etikës janë thelbësore për të siguruar që vlerësimet ose rishikimet që ata kryejnë janë të drejta, pa ndikim dhe të ligjshme.
4. Pavarësia dhe paanshmëria ndihmojnë në ndërtimin e besimit dhe njëkohësisht për t'i dhënë Këshillit të Etikës besueshmërinë dhe legjitimitetin.

5. Në dhënien e pavarësisë së anëtareve, është jashtëzakonisht e rëndësishme që autoriteti i tyre të ushtrohet në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.
6. Anëtarët e Këshillit të Etikës i shqyrtojnë rastet në mënyrë të paanshme, në bazë të fakteve, dhe në përputhje me ligjin, pa asnjë kufizim, ndikime të pahijshme, presione, kërcënime ose ndërhyrje, direkte ose indirekte.
7. Anëtarët e Këshillit e kanë për obligim të ruajnë pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre personale dhe në rast të çfarëdo presioni apo ndikimi të raportojnë tek organet përkatëse.
8. Gjatë procedimit të rasteve që kanë të bëjnë me shkeljet e Kodit të Etikës anëtarët e Këshillit të Etikës e kanë për obligim t'i shqyrtojnë ato sipas standardeve ndërkombëtare të drejtave të njeriut duke siguruar gjykim të drejtë.
9. Anëtarët e Këshillit të Etikës mbajnë përgjegjësi për shkeljet e standardeve ligjore dhe etike gjatë shqyrtimit të rasteve.

## **Neni 5**

### **Procedimi i rastit**

- 5.1 Para se Këshilli i Etikës të fillojë të merret me arsyet/rrethanat e një çështjeje\rasti, Këshilli kontrollon nëse ankesa e përfshirë ka të bëjë me Kodin e Etikës të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë. Këshilli i Etikës ka të drejtë të hedhë poshtë ankesat që nuk kanë të bëjnë me Kodin e Etikës ose janë të pabazuara. Këshilli, gjithashtu mund të hedhë poshtë ankesat nëse ato kanë të bëjnë me shkeljen e ligjeve në fuqi të cilat bien nën kompetencën e gjykatave. Këshilli i Etikës ka 30 ditë për të vendosur mbi besueshmërinë e ankesës, duke llogaritur datën kur i'u është dorëzuar ankesa.

Anëtarët e Këshillit të Etikës janë të obliguar të ruajnë fshehtësinë e të gjitha informatave dhe të dhënave që i paraqiten apo i merr nga parashtruesi i ankesës.

#### **5.2 Njoftimi**

Nëse Këshilli i Etikës pranon një ankesë që e konsideron si jo të plotë atëherë para se të refuzohet, Këshilli njofton palën për paqartësinë e ankesës dhe i jap palës një afat shtesë (15 ditë) gjatë së cilit mund të ofrojë informacionet e tij / saj shtesë për ankesën e parashtruar.

##### **5.1.1 Mbledhja e të dhënave**

a) Këshilli i Etikës nëpërmjet sekretarit/sekretares së Këshillit mbledh të dhënat e nevojshme për të vendosur mbi përmbajtjen e ankesës. Anëtarët e Këshillit të Etikës kanë qasje të papenguar në të dhëna lidhur me ankesën në arkivat e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, apo arkivat e fakulteteve. Zyrtarët administrative dhe stafi akademik i ofrojnë bashkëpunim anëtarëve të Këshillit për çështjet që kërkojnë dokumentim.

b) Në rastin e regjistrimeve audio, mbledhja e të dhënave do të bëhet me pëlqimin e personit të intervistuar. Kryetari i Këshillit të Etikës i drejtohet me shkrim personit që duhet intervistuar dhe i kërkon që pëlqimin e tij/saj të paraqes me shkrim.

c) Pala e cila ka parashtruar ankesë para Këshillit të Etikës mund të shoqërohet/paraqitet nga avokati/asistent, me shpenzimet e tij/saj personale.

d) Të dhënat e mbledhura mundësojnë përdorimin e tyre për të shqyrtuar rastet të cilat procedohen para Këshillit dhe si të tilla nuk mund të ndahet/dorëzohen asnjë autoriteti tjetër.

#### **Neni 6**

##### **E drejta për të kundërshtuar**

Para se Këshilli i Etikës të arrijë tek shqyrtimi përfundimtar mbi një ankesë, pala do të ketë mundësinë të deklarohet për ankesën e paraqitur, të gjitha të dhënat e mbledhura dhe pozicionin, nëse i posedon ato.

#### **Neni 7**

##### **Përpjekjet e zgjidhjes/pajtimit/konsensusit**

Pasi të vendoset mbi bazat e besueshmërisë të një çështjeje/rasti, Këshilli i Etikës mund në çdo kohë gjatë diskutimeve të tij të hulumtojë gatishmërinë e palëve për t'u pajtuar. Nëse palët vendosin të zgjidhin çështjen, Këshilli i Etikës do të mbështesë palët në arritjen e një zgjidhjeje.

#### **Neni 8**

##### **Vendimet e Këshillit të Etikës**

Vendimi i shqyrtimi final i Këshillit të Etikës mbi një ankesë duhet të jetë i arsyetuar dhe i qartë nëse është shkelur Kodi i Etikës i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë. Nëse Këshilli i Etikës nuk mund të arrijë në një përfundim të qartë për shkak të mungesës së informacionit mbi faktet e çështjes, ankesa do të hidhet poshtë. Nëse Anëtarët e Këshillit nuk mund të bien dakord nëse ka ndonjë shkelje, vendimi përfundimtar përcaktohet me mendimin e katër (4) anëtarëve që përbëjnë shumicën.

Këshilli i Etikës nuk vendos gjohë për shkeljet për të cilat nxjerr vendim, por nxjerr një vendim për çështjen dhe seriozitetin e shkeljes së Kodit të Etikës.

#### **Neni 9**

##### **Publikimi i vendimit të Këshillit të Etikës**

1. Vendimi i Këshillit të Etikës lidhur me një ankesë është i formës së shkruar. Vendimi i dorëzohet palëve nëpërmjet administratës. Po ashtu vendimi i dërgohet Rektorit për informacion dhe arkivim.
2. Pasi që vendimi me rekomandimet e Këshillit të Etikës ofron zbatimin e Kodit të Etikës, Këshilli i Etikës e ka për obligim t'i publikojë në formë të një përmbledhje të shkurtër të gjeturat dhe atë në web-faqen e internetit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, duke ofruar shpjegime rreth shkeljeve të dispozitave përkatëse të Kodit të Etikës.
3. Megjithatë, kjo mund të mos zbatohet në rastet kur Këshilli i Etikës konsideron se faktet dhe rrethanat janë konfidenciale, apo në rastet kur ankuesi ose pala e tretë kërkon

shprehimisht që identiteti i tij/saj dhe rrethanat që kanë të bëjnë me rastin të mos zbulohen.

## **Neni 10**

### **Vendimi i Këshillit të Etikës**

1. Pala e pa kënaqur me Vendimin e Këshillit të Etikës mund të paraqet ankesë në shkallë të dytë drejtuar komisionit për ankesa dhe parashtresa në kuadër të Senatit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të vendimit.
2. Komisionit për Ankesa mund të konfirmojë apo hedhë poshtë të gjeturat në vendimin e Këshillit të Etikës apo të njëjtin ta kthejë në rishqyrtim.

Kryesuesi i Senatit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë

